

VEPRA ARTI, ANTIKAT DHE PJESË TË KOLEKSIONISTËVE

Për qëllim të Nenit 352:

a) me “vepra arti” do të kuptojmë:

- fotografitë, kolazhet dhe pllakat e ngjashme dekorative, piktura dhe vizatime të bëra krejtësisht me dorë nga artisti, të ndryshme nga planet dhe pikturat e inxhinierisë arkitekturale, industriale, tregtare, topografike ose për qëllime të ngjashme, artikuj të përpunuar të dekoruar me dorë, skenografi teatrale, copë për sfondin e studiove ose copë e ngjashme me pëlhurën e pikturuar (kodi NK 9701).

- gdhendjet origjinale, gravurat dhe litografitë, që janë gdhendje(gjurmë) në numër të reduktuar, të bëra drejtpërsëdrejti në bardh e zi ose me ngjyra, të një ose disa pllakateve të ekzekutuara krejtësisht me dorë nga artisti, që nuk marrin parasysh procesin ose materialin e përdorur nga ai, por duke mos përfshirë asnjë proces mekanik ose fotomekanik (kodi NK 9702 00 00).

- skulpturat dhe statujat origjinale, në çdo material, me kusht që ato të jenë krejtësisht të bëra nga një artist; casts i skulpturës, prodhimi i të cilëve kufizohet në tetë kopje dhe është i mbikqyrur nga artisti ose pasardhësi i tij in title (kodi NK 9703 00 00).

- tapiceri (kodi NK 5805 00 00) dhe tekstile për mure (kodi NK 6304 00 00) të bëra me dorë, bazuar në vizatime origjinale të një artisti, me kusht që të mos ketë më shumë se tetë kopje për secilën.

- pjesë të shkëputura qeramike të bëra me dorë, të kufizuara në tetë kopje që kanë nënshkrimin e artistit ose të studios, të ndryshme nga artikujt të bizhuterisë, të arit dhe argjendit(wares).

- fotografi të marra nga artistë, të stampuara nga artisti ose nën mbikqyrjen e tij, të nënshruara dhe në një numër të kufizuar prej 30 copësh, duke përfshirë të gjitha përmasat dhe kornizat.

b) me “pjesë të koleksionistëve” do të kuptojmë:

- pullat postare ose pullat fiskale, vulat postare, zarfat e ditës së parë, letërshkrimet postare dhe të ngjashmet e tyre, të vulosura ose të pavulosura që nuk janë dalje të ligjshme dhe që nuk parashikohet të përdoret për një dalje të ligjshme (kodi NK 9704 00 00),

- koleksionet dhe pjesë të koleksionistëve me interes zoologjik, botanik, mineralogjik, anatomik, historik, arkeologjik, paleontologjik, etnografik ose numizmatik (kodi NK 9705 00 00),

c) me “antika” do të kuptojmë objekte të tjera, të ndryshme nga veprat e artit ose pjesë të koleksionistëve, të cilat janë më shumë se 100 vjet të vjetra (kodi NK 9706 00 00).